

Shërbimi
Leancor Plenum



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____/____/2025

Lënda: Depozitim projektligji.

Drejtuar: Z. Niko PELESHI

KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

I nderuar z. Kryetar,

Bazuar në nenin 78, 81 pika 1, 83 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenit 68, të Rregullores së Kuvendit, Ju paraqes për shqyrtim dhe miratim projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, të ndryshuar ”

Ju faleminderit.

DEPUTETI PROPOZUES

Erion MAJAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

“PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN Nr. 60/2016 “PËR SINJALIZIMIN DHE MBROJTJEN E SINJALIZUESVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI

I REPUBLIKA SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, të ndryshuar bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Neni 8 riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

1. *Sinjalizuesi që bën publikisht një sinjalizim mbi një shkelje të mundshme të kuadrit ligjor përfiton mbrojtje sipas këtij ligji, nëse plotësohet të paktën një nga kushtet e mëposhtme:*
 - a) *personi fillimisht ka sinjalizuar përmes mekanizmit të sinjalizimit të brendshëm dhe të jashtëm të sinjalizimit, ose ka kryer drejtpërdrejt një sinjalizim të jashtëm në autoritetin kompetent, por brenda afateve dhe kushteve të përcaktuara në këtë ligj nuk janë ndërmarre veprime të nevojshme si përgjigje ndaj tij;*
 - b) *sinjalizuesi ka arsye të bazuara për të besuar se:*
 - i. *shkelja paraqet një rrezik të menjëhershëm ose serioz për dëme të pakthyeshme në shëndetin publik, sigurinë, mjedisin ose interesin publik; ose*
 - ii. *adresimin efektiv i shkeljes është i kufizuar për shkak të rrethanave të veçanta, siç janë rastet kur ekziston rreziku që provat të fshihen ose shkatërrohen, ose kur autoriteti kompetent është bashkëpunëtor me të sinjalizuarin ose është vetë i përfshirë në shkelje.*

Neni 2

Neni 10 riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

1. *Çdo autoriteti publik dhe subjekt privat me më shumë se 50 punonjës, si dhe çdo ent me kapital shtetëror apo që është nën kontrollin e subjekteve shtetërore, ka detyrimin të krijojë njësi përgjegjëse për sinjalizimin, duke garantuar funksionimin efektiv të një mekanizmi të dedikuar për raportimin dhe ndjekjen e sinjalizimeve të brendshme.*
2. *Njësia përgjegjëse merr masa për ndërgjegjësimin dhe nxitjen e raportimit përmes kanaleve dhe procedurave të brendshme të sinjalizimit para përdorimit të kanaleve të jashtme, në rastet kur shkelja mund të trajtohet në mënyrë efektive brenda institucionit dhe kur personi raportues vlerëson se nuk ekziston rrezik hakmarrjeje, si dhe siguron informacionin e nevojshëm mbi përdorimin e këtyre kanaleve, si dhe mbi procedurat për raportim të jashtëm pranë ILDKPKI.*
3. *Njësia përgjegjëse mund të përbëhet nga një ose më shumë persona, sipas përbërjes dhe strukturës së organizatës, të trajnuar posaçërisht në fushën e mbrojtjes së sinjalizuesve.*
4. *Emërimi i punonjësit në njësinë përgjegjëse bëhet pas dhënies së pëlqimit të tij me shkrim.*
5. *Struktura, kriteret e përzgjedhjes dhe trajnimit të punonjësve të njësive përgjegjëse në subjektet private rregullohen nga vetë ato. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim marrëdhëniet e punës, strukturën dhe kriteret e përzgjedhjes së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike.*
6. *Njësia përgjegjëse paraqet pranë ILDKPKI-së, jo më vonë se data 15 janar e vitit pasardhës, raportin vjetor të konsoliduar mbi sinjalizimet e marra dhe trajtimin e tyre, sipas formatit të përcaktuar nga ILDKPKI.*

Neni 3

Në nenin 23 bëhen ndryshimet me përmbajtje si më poshtë:

Në pikën a shtohet fjalia: *“Në rast se shkelja përsëritet, autoriteti publik ose subjekti privat dënohet me gjobë 500 000 lekë”.*

Pas pikës d, shtohet pika dh, e dhe ë si më poshtë:

dh) mos përmbushja e detyrimit për dërgimin e raportit vjetor nga njësia përgjegjëse pranë autoritetit kompetent, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë;

e) pengimi, përpjekja ose kërcënimi për të penguar sinjalizimin, sipas parashikimeve të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 100,000 deri në 300,000 lekë;

ë) fillimi i procedurave të paligjshme ndaj sinjalizuesit dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 300 000 lekë.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

NIKO PELESHI

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN Nr. 60/2016 “PËR SINJALIZIMIN DHE MBROJTJEN E SINJALIZUESVE”, TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj ka për qëllim të përmirësojë mekanizmat ekzistues të sinjalizimit, duke zgjeruar mbrojtjen edhe për sinjalizimet publike. Ndër objektivat kryesorë është zgjerimi i rrethit të subjekteve që kanë detyrimin të krijojnë njësi përgjegjëse për sinjalizimin, me qëllim rritjen e llogaridhënies dhe përmirësimin e trajtimit të sinjalizimeve brenda institucionit.

Projektligji parashikon gjithashtu rishikimin dhe forcimin e masave administrative, përfshirë sanksione më të qarta dhe më proporcionale, veçanërisht në rastet e shkeljeve të përsëritura ose të mos përmbushjes së detyrimeve të raportimit.

Në tërësi, projektligji sjell ndryshime të pjesshme në ligjin ekzistues, me synimin për të rritur efektivitetin e mekanizmave të sinjalizimit dhe për të garantuar një nivel më të lartë mbrojtjeje për individët që raportojnë shkelje, duke krijuar një sistem më funksional, të sigurt dhe të besueshëm për trajtimin e sinjalizimeve.

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Një risi kryesore e projektligjit është shtrirja e mbrojtjes edhe tek sinjalizimet publike. Për herë të parë, individët që publikojnë informacion mbi shkelje të mundshme të kuadrit ligjor gëzojnë mbrojtje ligjore, kur plotësohen kushtet e përcaktuara në projektligj. Ky është një zhvillim thelbësor që rrit transparencën, fuqizon rolin e sinjalizuesve dhe krijon siguri juridike në rastet kur mekanizmat e brendshëm ose të jashtëm nuk janë efektivë ose të aksesueshëm.

Rritja e numrit të subjekteve të detyruara të ngrejë njësi përgjegjëse: Projektligji ul ndjeshëm pragun për krijimin e njësisë përgjegjëse, nga 80 punonjës në autoritetet publike dhe 100 punonjës në subjektet private, në 50 punonjës për të dy kategoritë.

Ky ndryshim zgjeron numrin e institucioneve të detyruara të krijojnë struktura për sinjalizimin, duke mundësuar mbulimin më të gjerë dhe funksionimin më efektiv të sistemit të raportimit.

Projektligji forcon kuadrin ndëshkues me qëllim sigurimin e respektimit të detyrimeve ligjore. Parashikohen:

- sanksione për mos krijimin e njësisë përgjegjëse,
- masa rënduese në rast përsëritjeje të shkeljes, deri në 500.000 lekë,
- masa administrative për çdo formë pengimi, kërcënimi apo diskriminimi ndaj sinjalizuesit.

Këto parashikime synojnë rritjen e disiplinës institucionale dhe efektivitetit të zbatimit të ligjit.

IV.VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është hartuar në mbështetje të neneve 81, 83 pika 1, si dhe 100 të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrim të legjislacionit me *acquis* të Bashkimit Evropian, ndaj nuk ka vlerësim të shkallës së përafrimit.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përmban 4 nene, përmbajtja të cilave mund të përmbledhet si vijon:

Në nenin 1 i projektligjit parashikon kushtet në të cilat një sinjalizim i bërë publikisht nga një sinjalizues përfiton mbrojtje sipas kuadrit ligjor në fuqi. Mbrojtja ligjore ofrohet kur sinjalizuesi ka ndjekur fillimisht procedurat për sinjalizim të brendshëm dhe/ose të jashtëm, ose ka paraqitur një sinjalizim të drejtpërdrejtë pranë autoritetit kompetent, por brenda afateve dhe kushteve të përcaktuara nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për adresimin e çështjes. Po ashtu, mbrojtja zbatohet edhe kur sinjalizuesi ka arsye të bazuara për të besuar se shkelja përbën një rrezik të menjëhershëm apo serioz për dëme të pakthyeshme në shëndetin publik, sigurinë, mjedisin ose interesin publik; ose adresimi efektiv i shkeljes është i kufizuar për shkak të rrethanave të veçanta, siç janë rastet kur ekziston rreziku që provat të fshihen ose shkatërrohen, ose kur autoriteti kompetent është bashkëpunëtor me të sinjalizuarin ose është vetë i përfshirë në shkelje. Kjo dispozitë synon të balancojë nevojën për transparencë me garantimin e mbrojtjes së sinjalizuesit edhe në rastin e publikimit të informacionit.

Neni 2 i projektligjit sjell një ndryshim të rëndësishëm dhe thelbësor në drejtim të organizimit të mekanizmave të brendshëm të sinjalizimit, duke vendosur detyrime të qarta për autoritetet publike dhe subjektet private.

Së pari, neni përcakton se çdo autoritet publik dhe subjekt privat me më shumë se 50 punonjës, si dhe çdo ent me kapital shtetëror apo që është nën kontroll shtetëror, ka detyrimin të krijojë një njësi përgjegjëse për sinjalizimin. Përmes këtij parashikimi, projektligji synon të garantojë funksionimin efektiv të një mekanizmi të dedikuar për raportimin dhe ndjekjen e sinjalizimeve të brendshme, duke rritur ndjeshëm numrin e subjekteve të detyruara të vendosin struktura të specializuara.

Njësia përgjegjëse ka gjithashtu detyrimin të ndërmarrë masa për ndërgjegjësimin dhe nxitjen e përdorimit të kanaleve të brendshme, në ato raste kur shkelja mund të trajtohet në mënyrë efektive brenda institucionit dhe kur raportuesi vlerëson se nuk ekziston rrezik hakmarrjeje. Po ashtu, ajo duhet të sigurojë informacion të plotë mbi mënyrat e raportimit, si brenda institucionit, ashtu edhe përmes kanaleve të jashtme pranë ILDKPKI-së.

Parashikimet e nenit përcaktojnë gjithashtu se njësia përgjegjëse mund të përbëhet nga një ose më shumë persona, në varësi të strukturës së organizatës, të cilët duhet të jenë të trajnuar posaçërisht në fushën e sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve. Emërimi i tyre bëhet vetëm pas dhënies së pëlqimit me shkrim, duke garantuar vullnetarizëm dhe integritet në ushtrimin e funksioneve.

Sa i përket rregullimit të brendshëm, projektligji përcakton se subjektet private rregullojnë vetë kriteret dhe strukturën e njësisë përgjegjëse, ndërsa për autoritetet publike, këto elemente përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në vijim të detyrimeve funksionale, neni parashikon se njësia përgjegjëse duhet të paraqesë pranë ILDKPKI-së raportin vjetor të konsoliduar mbi sinjalizimet e marra dhe trajtimin e tyre, jo më vonë se data 15 janar e vitit pasardhës, sipas formatit të përcaktuar nga autoriteti kompetent. Ky raportim synon të sigurojë monitorim, standardizim dhe rritje të llogaridhënies në zbatimin e ligjit.

Neni 3 i projektligjit parashikon kundërvajtjet dhe masat administrative. Ky nen përcakton qartë masat administrative që zbatohen në rast të shkeljeve të dispozitave të ligjit për sinjalizimin, kur këto shkelje nuk përbëjnë vepër penale. Këto shkelje trajtohen si kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me gjoba të përcaktuara sipas natyrës dhe rëndësisë së shkeljes.

Gjobat variojnë nga 100,000 deri në 500,000 lekë, në varësi të llojit të shkeljes. Këto masa synojnë të garantojnë funksionimin korrekt të sistemit të sinjalizimit dhe të mbrojnë sinjalizuesit nga çdo formë presioni apo hakmarrjeje.

Një ndër sanksionet e parashikuara në këtë dispozitë është edhe vendosja e gjobës në vlerën 500,000 lek, në rast të përsëritjes së shkeljes, për mos krijimin e njësisë përgjegjëse.

Neni 4 i projektligji parashikon afatin e hyrjes në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohen ILDKPKI-ja, të gjitha autoritetet e tjera publike dhe subjektet private të cilat kanë më shumë se 50 punonjës, në përputhje me strukturën organizative të institucionit apo subjektit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projekt akti është hartuar nga deputeti nismëtar.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektakti nuk shoqërohet me efekte financiare.